



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN  
DHE TURIZMIT  
BASHKIA MAT  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2020

Burrel, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Për: Operatori Ekonomik: “CARA” Sh.p.k, me numër Nipt-i: K07729920F,**

**Me adresë: Diber Burrel BURREL Lagjja “Pjeter Budi”, Rruga “Abdi Mati”, Ndertese private Nr.10,**

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Punë”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-57219-04-30-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim i rrjetit të Kuz Blloku Drita Nr.1 dhe Drita Nr. 2 dhe lagjja e Re, qyteti Burrel”, me fond limit: 71 820 319 (shtatëdhjetë e një milion e tetëqind e njëzet mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, ndarë për vitin 2020 në vlerën: 14 364 064 (katërmëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH nga grandit, për vitin 2021 në vlerën: 25 000 000 (njëzet e pesë milion) lekë pa TVSH nga grandit, ndërsa për vitin 2022 në vlerën: 32 456 255 (tridhjetë e dy milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH nga grandit, me afat realizimi të punimeve: 6 (gjashtë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 26 datë 11 Maj 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “S P E K T R I” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J62903555F  
Vlera: 49 316 925 (dyzet e nëntë milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH
2. Operatori Ekonomik: “CARA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K07729920F  
Vlera: 71 754 165 (shtatëdhjetë e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

3. Operatori Ekonomik: “ALPHA SOLUTIONS GROUP” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L63620402U

Vlera: *Nuk ka paraqitur ofertë.*

**Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori Ekonomik: “S P E K T R I” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J62903555F
2. Operatorin Ekonomik: “ALPHA SOLUTIONS GROUP” Sh.p.k., me numër Nipt-i: L63620402U

***Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:***

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, shoqëria “S P E K T R I” Sh.p.k., dhe “ED KONSTRUKSION” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:

**I. Nuk është përmbushur përcaktimi i Kritereve të Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

*“Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:*

*a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*

*b. Prokura e posaçme.”*

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në tender, pasi në Kontratën e Bashkëpunimit (*marrëveshje e noterizuar*) nuk janë përcaktuar pjesët e punimeve të preventivit objekt prokurimi që kanë marrë përsipër secili, por vetëm % (*përqindjen*) e pjesëmarrjes, në kundërshtim kjo me përcaktimet e pikës 1 dhe 2 të nenit 74 të VKM-së Nr.914, datë 29.12.2014 (*i ndryshuar*).

**II. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “a” të pikës 2.3.1 (Përvoja të mëparshme)/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

**2.3.1 (Përvoja të mëparshme)**

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** (*që i korrespondon vlerës 35 910 160 lekë*) e fondit limit që është realizuar gjatë tri viteve te fundit.

ose

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së

bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** (që i korrespondon vlerës 143 640 640 lekë) e fondit limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon :

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore (për çdo situacion)*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore (për çdo situacion)*
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr.8*

Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse zërat kryesore të punimeve kanë volume të konsiderueshme krahasimore të përcaktuara në këtë prokurim.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, shoqëria “SPEKTRI” Sh.p.k., nuk përmbush kushtin e punimeve të ngjashme në raport me përqindjen e punimeve që ka marrë përsipër në bazë të preventivit të ofertuar, si dhe Faturat Tatimore Shitje për kontratat e paraqitura për përmbushjen e këtij kriteri, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor, pasi janë të pafirmosura nga ana e investitorit (blerësit) , e 2 (dy) prej tyre janë të pavulosura nga shitësi, si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “ED KONSTRUKSION” Sh.p.k., konstatohet se faturat tatimore Shitje për kontratat e paraqitura të cilat kanë zëra punimesh të ngjashme, nuk janë të plotësuar sipas legjislacionit tatimor, pasi janë të pafirmosura nga ana e investitorit (blerësit) dhe shitësit si dhe të pavulosura nga ky i fundit.**

### **III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.4/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e**

## **Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

### **2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:**

- **ISO 9001** (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) e përditësuar
- **ISO14001** (Për Menaxhimin e Ambjentit) e përditësuar
- **OHSAS 18001**(Për Kushtet e Sigurisë dhe të Shëndetit të Punonjësve) e përditësuar
- **ISO 39001** (Për menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor) e përditësuar
- **ISO 27001** (Për menaxhimin e sigurisë së informacionit) e përditësuar
- **ISO 28001** (Për menaxhimin e sigurisë për zinxhirin e furnizimit) e përditësuar
- **ISO 8000** (Për menaxhimin e përgjegjësisë shoqërore) e përditësuar
- **ISO 3834-2** (Për menaxhimin e kushteve të cilësisë për shkrirjen e metaleve) e përditësuar
- **PAS 99** (Për menaxhimin e integruar) e përditësuar
- **DS CEN/TR 15128:2005** (Sistemi i menaxhimit për shqyrtimin e standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit) e përditësuar
- **BS EN 13331-1:2002** (Sistemi i menaxhimit për sistemet për veshjet e kanaleve, specifikimet e produkteve) e përditësuar

ISO-t e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar natyrës së punimeve të cilat kanë marrë përsipër, shoqëria “SPEKTRI” Sh.p.k., nuk disponon Çertifikatën OHSAS 18001 (Për Kushtet e Sigurisë dhe të Shëndetit të Punonjësve) e përditësuar, ndërsa shoqëria “ED KONSTRUKSION” Sh.p.k., nuk disponon Çertifikatat DS CEN/TR 15128:2005 (Sistemi i menaxhimit për shqyrtimin e standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit) e përditësuar, dhe BS EN 13331-1:2002 (Sistemi i menaxhimit për sistemet për veshjet e kanaleve, specifikimet e produkteve) e përditësuar.**

## **IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

*2.3.5 Për materialet **Tubacione Plastike** dhe materialet **Hidraulike** të përcaktuara në preventivin e investimit objekt prokurimi, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë:*

1. *Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.*

2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

**Shënim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara
4. Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standerteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar natyrës së punimeve të cilat kanë marrë përsipër, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, shoqëria “SPEKTRI” Sh.p.k., nuk disponon **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për materialet “Tubacione Plastike”** të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi, ku konkretisht për materialet: *Tuba te brinjezuar HDPE SN8 Dn=250 mm* dhe *Tuba te brinjezuar HDPE SN8 Dn=600 mm*, ndërsa shoqëria “ED KONSTRUKSION” Sh.p.k., nuk ka paraqitur **dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera për materialet “Tubacione Plastike”** të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi

**V. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6 gërma “a)/4” / 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

*2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 95 (nëntëdhjetë e pesë) punonjës për periudhën Prill 2017 – Prill 2020, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik.*

**a) Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:**

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
  2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.
  3. Formularët e deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore (**FDP**) për periudhën e mësipërme.
  4. Mandat pagesat e (**FDP**) dhe (**TAP**) për periudhën e mësipërme.
- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, shoqëria “SPEKTRI” Sh.p.k., nuk ka paraqitur Mandat pagesën bankare të FDP-së për muajin Prill 2017.

**VI. Nuk është përmbushur përcaktimi i gërmës “b” pikës 2.3.6/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

*b) Operatori ekonomik duhet të ketë minimum 25 (njëzet e pesë) punonjës të punësuar për tre muajt e fundit të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), nga të cilët të jenë të paktën punonjës me specialitetin:*

- *Inxhinier per instruktimin teknik te punonjesve – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Teknik ndërtimi - jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Hidraulik – jo më pak se 4 (katër) punonjës*
- *Karpentiere – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Elektromekanik – jo më pak se 1 (një) punonjës*
- *Murator – jo më pak se 3 (tre) punonjës*
- *Punëtor ndërtimi – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Punonjes per punime PVC dhe Gome – jo më pak se 2 (dy) punonjës*
- *Manovratore – jo më pak se 4 (katër) punonjës mjeteve të rënda.*
- *Shofer mjeteve – jo më pak se 4 (katër) punonjës.*

*\* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme), kontrata e punës e vlefshme si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar natyrës së punimeve të cilat ka marrë përsipër, shoqëria “SPEKTRI” Sh.p.k., në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nuk ka paraqitur *Kartelat personale përkatëse të Sigurimit Teknik (të vlefshme) për punonjësit me specialitetin: Teknik ndërtimi, Murator, Punëtor ndërtimi, Manovratore dhe Shofer mjeteve, ndërsa shoqëria “ED KONSTRUKSION” Sh.p.k., nuk disponon punonjës me specialitetin Punonjes per punime PVC dhe Gome.***

**VII. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Për kapacitetin teknik/ Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit:**

*2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier ndërtimi në pronësi ose me qera për magazinimin e materialeve në një distancë jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) km nga Njësia Administrative Burrel, ku të jetë në ekstraktin e shoqërisë ose të qeradhënësit, si dhe duhet të paraqitet:*

- *Dokumentacioni që vërteton pronësinë ose kontratën noteriale të qerasë në rast se kantieri është me qera.*
- *Leje Mjedisi nga QKL, (Kodi III.1.B) – Leje mjedisore për poligon prodhimi dhe nyje larëse*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, kantieri i paraqitur nuk është në një distancë jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) km nga Njësia Administrative**

**Burrel, si dhe nuk është i pajisur me Leje Mjedisi nga QKL, (Kodi III.1.B), përkatësit për poligon prodhimi dhe nyje larëse.**

- ❖ Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejtë se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës: **“ALPHA SOLUTIONS GROUP”** sh.p.k, nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (sipas Shtojcë 1 të DST-së) në zbatim të nenit 17 të Vendimit Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar), **si dhe dokumentat e kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit,**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë **Operatorin Ekonomik: “CARA”** Sh.p.k, me numër Nipt-i: **K07729920F**, me **adresë: Diber Burrel BURREL Lagjja “Pjeter Budi”, Rruga “Abdi Mati”, Ndertese private Nr.10**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **71 754 165 (shtatëdhjetë e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **22.06.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**